VENDIM
Nr. 587, datë 22.7.2020

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR

(ndryshuar me VKM nr. 758, datë 23.9.2020, nr. 936, datë 25.11.2020; nr. 111, datë 24.2.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, shkronja "a", pika 1, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 17 572 719 126 (shtatëmbëdhjetë miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e njëqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

2. Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2020, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

2.1 Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 274 877 807 (dyqind e shtatëdhjetë e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

3. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 1 671 284 846 (një miliard e gjashtëqind e shtatëdhjetë e një milionë e dyqind e tetëdhjetë e katër mijë e tetëqind e dyzet e gjashtë) lekësh pa TVSH.

3.1 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime kapitale me financim të brendshëm" të programit 06210 "Programe zhvillimi", i shtohet fondi prej 274 877 807 (dyqind e shtatëdhjetë e katër milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e shtatë) lekësh, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

4. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin "Fondi për rindërtim", të buxhetit të shtetit.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama